



KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359
Web: www.kolegjidardania.com

1. RAPORT I PËRMBLEDHUR

Procesi i vlerësimit të institucionit, kursit/syllabusit dhe mësimdhënësit është një mjet i rëndësishëm për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të siguruar që Kolegji Dardania po kryen detyrat e tij me sukses. Disa ndryshime cilësore pozitive pas vlerësimit të fundit të vitit akademik 2021/2022 mund të argumentojnë për zhvillimin pozitiv të institucionit dhe të programit të studimeve.

1.1 - Gjetjet për institucionin

- Integrimi në reformimin cilësor të shërbimeve;
- Infrastruktura bashkëkohore;
- Infrastruktura për studentë (kampusi, hapësirat e studimit, biblioteka, kafeteria, si dhe hapësirat e tjera që ndihmojnë studentët të kenë një eksperiencë të suksesshme;
- Stafi cilësor dhe me përvojë;
- Mbështetja e kërkimit dhe inovacionit;
- Të dhëna dhe analizë e performancës;
- Përmirësimi i shërbimeve të këshillimit dhe mbështetjes për studentët;
- Ndërtimi i lidhjeve ndërkombëtare;
- Transparencë financiare;
- Transparencë e rezultateve;
- Mbështetja e arritjeve të studentëve;
- Sigurimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- Përbushja e kërkesave ligjore dhe akademike;
- Rritja e investimeve në kërkim dhe zhvillim.

1.2 - Rekomandimet për institucionin

- Organizimi i aktiviteteve të natyrës kulturore-arsimore me studentë;
- Të organizohen më shumë aktivitete sportive, si: turnire të shahut, gara në mes të studentëve të IAL-ve, etj.

2.1 - Gjetjet për lëndën/kursin-syllabusin

- 87.3% e kurseve të obliguara janë të përpiluara drejtë dhe aftësojnë për programin përkatës;
- 74.6% e kurseve me zgjedhje janë të dobishme për aftësim në fushën përkatëse;
- 100% e kurseve janë të planifikuara sipas KKE dhe KK të Kosovës;

- Syllabuset i përmbajnë të gjitha kërkesat karakteristike për informimin dhe orientimin e drejtë të studentit, duke filluar nga përshkrimi i lëndës, rezultatet e pritshme, tabela për shpërndarjen e ECTS-krediteve, kriteret e vlerësimit të studentëve, metodologjia e punës, temat për 15 javë dhe literatura obligative dhe ajo ndihmëse, etj.
- Përmbajtjet që ligjërohen janë sfiduese dhe mjaft interesante.

2.2 - Rekomandimet për lëndën/kursin-syllabusin

- 12% të freskohen syllabuset me literaturë të burimeve të viteve të fundit;
- 8.3% e syllabuseve duhet të ristrukturojnë tabelën për distribuimin e krediteve ECTS;
- Në syllabuse të natyrës praktike të parashihet puna me projekte.

3.1 - Gjetjet për mësimdhënësin

- 90.1% e përgjigjeve të studentëve rezultojnë se stafi akademik ka përgatitjen e duhur për të ligjëruar kurset nga fusha e tyre e ekspertizës. Kjo është një gjetje shumë pozitive që tregon se studentët kanë besim në aftësitë e mësimdhënësve të tyre;
- 91.8% e studentëve vlerësojnë se ligjëruesit aplikojnë strategji për mësimdhënie me studentin në qendër. Ky është një faktor i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe cilësinë e përgatitjes së studentëve;
- 94.3% e përgjigjeve të studentëve udhëzojnë në konstatimin se stafi akademik ka qëndrim profesional dhe bashkëpunim miqësor me studentë;
- 92% të stafit akademik zotërojnë me kompetencë kurset të cilat i ligjërojnë;
- Nga vlerësimi i studentëve rezulton se rreth 10.4% e mësimdhënësve dhe e bashkëpunëtorëve duhet të gjenerojnë më shumë në veprimtarinë arsimore.

3.2 - Rekomandimet për stafin akademik

- Trajnime për mësimdhënie të avancuar. Të organizohet cikël trajnimesh për 10.4% të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve që nuk disponojnë përgatitjet metodologjike të nevojshme;
- 10.4% e mësimdhënësve dhe e bashkëpunëtorëve të trajnohen në metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo përfshin përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, përdorimin e burimeve online, dhe metodat e reja të angazhimit të studentëve;
- Një pjesë e vogël e stafit akademik duhet të vazhdojnë aktivitetet në zhvillim profesional për të ngritur aftësitë akademike e praktike që me kompetencë të plotë të ligjërojnë kurset e tyre;
- Një pjesë e vogël e stafit duhet të trajnohen për mësimdhënie bashkëkohore për t'i ikur ligjërimit "ex-katedra".

2. REKOMANDIME PERFUNDIMTARE

Rezultatet pozitive të vlerësimit semestral tregojnë për suksesin e institucionit, kursit/syllabusit dhe mësimdhënësve. Duke pasur parasysh se vetëm 0.6% e instrumenteve nuk u plotësuan në mënyrë korrekte, kjo dëshmon nivelin e lartë të angazhimit dhe përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit.

Pas përpunimit të 99.4% të pyetësorëve dhe 100% të formularëve të vëzhguesve, mbështetur në rezultatet, burojnë rekomandimet në vijim:

- *Kolegjit Dardania edhe më tutje duhet të vazhdojë procesin e vlerësimit të institucionit, të kurseve/syllabuseve dhe të mësimdhënësve sepse përfshirja e lartë e studentëve në procesin e vlerësimit duke kurajuar ata që të marrin pjesë në evaluim dhe të ndajnë mendimet e tyre shpie drejtë rrugës më të mirë për identifikimin e gjendjes dhe planifikimin e aktiviteteve vijuese për mirëmbajtjen dhe ngritjen e cilësisë;*
- *Kolegji Dardania duhet të angazhohet më tepër që për studentët të organizojë më shumë aktivitete sportive, si: turnire të shahut, gara në mes të studentëve të IAL-ve;*
- *Stafi akademik duhet të rishikojë syllabuset dhe të përditësojë listat e literaturës me burime të viteve të fundit për të pasur një përmbajtje të përditësuar;*
- *Stafi akademik të rishikojë syllabuset me qëllim të përditësimit të tabelave të ngarkesës së studentit dhe të shpërndarjes së krediteve;*
- *Mësimdhënësit e kurseve të natyrës praktike rekomandohet që të përfshijnë punën me projekte në syllabuset e tyre për studentët;*
- *Stafi akademik duhet të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme përmes aplikimit të programeve trajnuese për t'i ikur mësimdhënies 'ex katedra' dhe për të ofruar mësimdhënie bashkëkohore;*

Nga Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie, të përpilohen agjenda dhe të sigurohen trajnerë të certifikuar për mësimdhënie bashkëkohore në institucionet e arsimit të lartë. Në këtë kuptim, duhet të zhvillohen disa programe, si:

- *Trajnimi i stafit akademik për aplikimin e teknologjisë në mësimdhënie.*
- *Trajnimi i stafit akademik për mësimdhënie efektive dhe zbatimin e mësimi problemor.*
- *Trajnimi i stafit akademik për përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të studentëve;*
- *Trajnimi i stafit akademik për zhvillimin e shkathtësive për prezantime të suksesshme;*
- *Programi për aftësimin e mësimdhënësve për të ndihmuar studentët në arritjen e shkathtësive bazë akademike: të dëgjuarit aktiv, të folurit e suksesshëm, të lexuarit e kuptimshëm, dhe të shkruarit akademik;*
- *Promovimi i diversitetit kulturor dhe gjuhësor në mësimdhënie;*

- *Krijimi i platformave të ndryshme për shkëmbim të përvojave mes trajnerëve dhe pedagogëve të tjerë;*
- *Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të programeve të përsosmërisë në mësimdhënie;*
- *Puna me projekte;*
- *Sistemi administrativ për mbrojtjen e të dhënave.*

2.1 Plani i implementimit të rekomandimeve

Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie, në bashkëpunim me Zyren për Sigurimin e Cilësisë, është e obliguar të organizojë së paku tre trajnime në bazë të rekomandimeve të mësipërme, brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit vijues, pra jo më vonë se dhjetor 2023.

Plani i organizimit të trajnimeve është si vijon:

Trajnimi I: Si të shkruajmë punime kërkimore shkencore;

Trajnimi II: Si të hartohen projektet kërkimore;

Trajnimi III: Si të publikohen lektionet në platformën DMIS dhe Google Classroom;

Trajnimi IV: Si të aplikohet qasja PRKV - Planifiko-Realizo-Kontrollo-Vepro;

Trajnimi V: Trajnimi për Shkathtësitë e prezentimit;

Trajnimi VI: Trajnimi për Mësimdhënie aktive dhe ndërvepruese.

ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË